



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

AMENDAMENTI NR. 7
NË MARRËVESHJEN PËR ASISTENCË
NË MES TË
SHTETEVE TË BASHKUARA TE AMERIKËS
DHE
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Marrëveshja Nr. [167-AA-09-01/07]

AMENDAMENTI NR. 7
NË MARRËVESHJEN PËR ASISTENCË

Në mes të

Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vepron përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ("USAID")

dhe

Republikës së Kosovës (më tutje në tekst: "Pranuesi i Grantit")

Qëllimi i Amendamentit

Më 14 shtator 2009, Palët e kanë nënshkruar Marrëveshjen për Asistencë për Zhvillim Ekonomik; më 2 shtator 2010, Palët e kanë nënshkruar Marrëveshjen e Modifikuar dhe të Riformular për Asistencë; më 1 shtator 2011, Palët e kanë nënshkruar Amendamentin Numër Dy në Marrëveshjen për Asistencë; më 22 gusht 2012, Palët e kanë nënshkruar Amendamentin Numër Tre në Marrëveshjen për Asistencë; më 17 shtator 2012, Palët e kanë nënshkruar Amendamentin Numër Katër në Marrëveshjen për Asistencë; më 28 shtator 2012, Palët e kanë nënshkruar Amendamentin Numër Pesë në Marrëveshjen; dhe më 12 korrik 2013, Palët e kanë nënshkruar Amendamentin Numër Gjashtë në Marrëveshjen për Asistencë (së bashku, me këtë Amendament Numër Shtatë, "Marrëveshja").

Ky Amendament Numër Shtatë ("Amendamenti") arrihet në mes të dy Palëve për t'i dhënë Pranuesit të Grantit një shumë shtesë prej Njëqind Mijë Dollarësh Amerikanë (\$100,000) dhe për të modifikuar buxhetin në pajtim me të. Kjo shumë plotësuese e fondeve e sjell totalin e fondeve që janë obliguar deri më tani sipas Marrëveshjes tek një shumë që nuk tejkalon vlerën prej Njëqind e Dyzet e Pesë Milionë, e Shtatëqind e Njëzet e Dy Dollarë Amerikanë (\$145,000,722).

Tani, Palët duan të ndryshojnë Marrëveshjen si vijon:

1. Neni 3: Kontributet e Palëve.

Për të rritur shumën e grantit, Paragrafi 3.1(a) modifikohet dhe zëvendësohet në tërësi me paragrafin në vijim:

"(a) *Granti.* Për të ndihmuar arritjen e Objektivit, të paraqitur në këtë Marrëveshje, USAID-i, në pajtim me Dekretin për Asistencë të Jashtme të vitit 1961, me këtë Amendament, i dhuron Pranuesit të Grantit, sipas kushteve të parapara me këtë Marrëveshje, shumën që nuk e tejkalon vlerën prej Njëqind e Dyzet e Pesë Milionë, e Shtatëqind e Njëzet e Dy Dollarë Amerikanë (\$145,000,722). ("Granti")."

2. Shtojca 1 në Përshkrimin e Zgjeruar të Marrëveshjes së Modifikuar dhe të Riformular për Asistencë

Bëhet modifikimi i fushave programore: “**Rinia, Punësimi dhe Pjesëmarrja**”, si dhe prezantimi i planit të modifikuar/azhurnuar financiar:

- (a) Në këtë mënyrë, Aneksi 1 modifikohet duke e zëvendësuar tekstin e mëparshëm për fushën programore: “Rinia, Punësimi dhe Pjesëmarrja” me tekstin në vijim:

Punësimi dhe pjesëmarrja e të rinjve

USAID-i synon t’i mbështesë ndërmarrësit e rinj për të krijuar biznese të qëndrueshme dhe për të kontribuar në krijimin e vendeve të reja të punës. Qëllimi është që të adresohet shkalla e lartë e papunësisë në mesin e të rinjve.

Përshkrimi i Aktiviteteve:


- Trajnime për ndërmarrësi dhe ndërmarrje;
- Asistencë për të siguruar mbështetje financiare;
- Asistencë teknike, mentorim, trajnim dhe krijim i lidhjeve afariste.
- Vullnetarët e “Korpusit të Paqes”-it do të punojnë me rininë, dhe me organizatat lokale dhe shkollat, për ta adresuar zhvillimin ekonomik, çështjet e rinisë, çështjet gjinore, çështjet e pakicave dhe të pajtimit ndëretnik.


(b) Shtojca 1 është modifikuar edhe më tutje duke zëvendësuar në tërësi Nënshtojçën A në Shtojcën 1 me Shtojcën e paraqitur në këtë Amendament.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Pranuesi i Grantit, secili përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje dhe e kanë dorëzuar në ditën dhe vitin e lartshënuar.

SHTETET E BASHKUARA
TË AMERIKËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga: 
Emri: Maureen A. Shauket
Titulli: Drejtoreshë e Misionit të USAID-it
në Kosovë

Nga: 
Emri: Atifete Jahajaga
Titulli: Presidente e Republikës së
Kosovës

20-09-2013

Nënshtojca A në Shtojcën 1: Plani Ilustrues Financiar (në Dollarë Amerikanë)

Fusha Programore	Shuma në Marrëveshjen e Mëparshme për Asistencë	Shuma Plotësuese sipas Marrëveshjes së Modifikuar për Asistencë, Mod. 7	Shuma Totale e Zotuar
Sundimi Efektiv i Ligjit	\$23,651,461		\$23,651,461
Qeverisja e Mirë	\$8,870,274		\$8,870,274
Asistenca për Kuvendin/Partitë Politike	\$2,000,000		\$2,000,000
Energjia	\$8,008,791		\$8,008,791
Baza Makroekonomike për Zhvillim	\$18,010,016		\$18,010,016
Përmirësimi i Ambientit Afarist	\$19,083,000		\$19,083,000
Bujqësia	\$10,396,763		\$10,396,763
Punësimi dhe Pjesëmarrja e Rinisë	\$7,827,000	\$100,000	\$7,927,000
Lidershipi Transformues	\$14,950,003		\$14,950,003
Lehtësimi i Kredive dhe Ndërmjetësimi Financiar	\$9,000,000		\$9,000,000
Zbutja e Konfliktit	\$9,284,235		\$9,284,235
Mbështetja Programore	\$13,819,179		\$13,819,179
TOTAL	\$144,900,722	\$100,000	\$145,000,722